

# Mediumet ti respektojnë standardet profesionale

**Shkup, 05.02.2016** – Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale i fton të gjitha mediumet që të tregojnë përgjegjësi profesionale dhe ta realizojnë punën e tyre duke ju përmbajtur standardeve dhe parimeve më të larta të gazetarisë. Në këtë moment të ndjeshëm për shoqërinë e Maqedonisë, Agjencia i përkujton mediumet se duhet të informojnë në mënyrë objektive dhe të paanshme me ç’rast në mënyrë të njëjtë duhet të trajtojnë këndvështrimet dhe mendimet e ndryshme, duke mundësuar që publiku të formojë lirshëm mendimin e tyre për ngjarjet dhe çështjet e caktuara. Në këtë drejtim, gazetarët duhet të bëjnë një dallim të qartë në mes të fakteve dhe komenteve, vazhdimisht duke llogaritur se faktet janë të pakontestueshme, ndërsa komentet gazetareske – përveç që janë të lira, duhen patjetër të jenë edhe të vërteta.